

20250501090

АГЕНЦИЈА ЗА УПРАВУВАЊЕ СО ОДЗЕМЕН ИМОТ

Bazuar në nenin 16 paragrafi 1 paragrafi 6 të Ligjit për administrimin e pasurisë së konfiskuar, interesave pasurore dhe sendeve të sekuestruara në procedurë penale dhe kundërvajtëse (*) ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 64/24 dhe 37/25) dhe në pajtim me nenin 15 paragrafin 1 të statutit Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar nr. 02-4368/2, datë 2.12.2024, Bordi Drejtues i Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar në seancën e dytë me radhë për vitin 2025 të mbajtur më 7.2.2025 ka miratuar si vijon

RR E G U L O R R E PËR MËNYRËN E DHËNIES NË PËRDORIM TË PRONËS PËRKOHËSISHT TË KONFISKUAR ORGANEVE SHTETËRORE, SHOQËRIVE DHE FONDACIONEVE

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet mënyra e marrjes së pasurisë përkohësisht të konfiskuar organeve shtetërore, shoqatave dhe fondacioneve.

Të punësuarit e Agjencisë së Menaxhimit të Pasurisë së Konfiskuar (në tekstin e mëtejme: Agjencia) me pronën përkohësisht të konfiskuar, pronën e konfiskuar, përfitimim pasuror dhe lëndët e marra sillen si nikoqirë të mirë dhe ekonomistë të ndërgjegjshëm.

Neni 2

Disa terma në këtë Rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. "Pronë përkohësisht e konfiskuar, përfitimim pasuror dhe lëndët e konfiskuara" nënkuptohen pasuri, përfitimime pasurore dhe gjësendet për të cilat zhvillohen procedura penale dhe kundërvajtëse dhe për konfiskimin e të cilave nuk ka vendim të formës së prerë.

2. "Nëpunësit administrativë të Agjencisë" (në tekstin e mëtejme: përmbarues) janë personat e punësuar nga Agjencia, të cilët e marrin pronën e sekuestruar në procedurë penale dhe kundërvajtëse dhe më tej e vendosin në një nga depot e Agjencisë në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit.

3. "Dorëzues i gjësendeve" është personi i autorizuar nga institucioni kompetent që ka marrë pronën, përfitimimet pasurore dhe lëndët.

Neni 3

Prona përkohësisht e konfiskuar ose gjësendet përkohësisht të konfiskuara, nuk mund të jenë gjësende të shitjes, me përjashtim të rasteve kur menaxhimi me pasurinë e tillë shoqërohet me shpenzime më të mëdha ose shpenzime të mirëmbajtjes e tejkalojnë vlerën e pronës ose gjësendeve, ose në rastet kur personi nga i cili prona e paluajtshme është konfiskuar ka dhënë pëlqimin me shkrim për shitjen, me qëllim të ruajtjes së vlerës së pronës së paluajtshme.

Në rastet kur bëhet fjalë për lëndët nga paragrafi 1 i këtij neni, personi të cilit i janë konfiskuar gjësendet ose drejtori i Agjencisë, mund të parashtrojë kërkesë organit kompetent (prokurorit publik, gjykatës ose organit shtetëror), për marrjen e pëlqimit për shitjen e pasurisë së konfiskuar përkohësisht, me qëllim të ruajtjes së vlerës së saj. Drejtori, paraqet kërkesën në afat prej tri ditësh nga dita e përcaktimit të nevojës për shitje, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Pas marrjes së pëlqimit nga organi kompetent, drejtori është i obliguar që pronën e konfiskuar përkohësisht ta shesë në pajtim me dispozitat e Ligjit të Menaxhimit të Pasurisë së Konfiskuar dhe Përfitimet Pasurore dhe Lëndët të Konfiskuara në Procedurë për Kundërvajtje dhe Penale, si dhe mjetet e marra t'i mbajë në llogarinë për qëllime të veçanta të Agjencisë, për të cilën bëhet procesverbal, i cili tregon ditën e shitjes dhe vlerën e pasurisë së shitur që është depozituar në llogarinë e përkohshme, si dhe ditën dhe orën e depozitimit të parave.

2. MARRJA E PRONËS PËRKOHËSISHT TË KONFISKUAR ORGANEVE SHTETËRORE, SHOQËRIVE DHE FONDACIONEVE

Neni 4

Lëndë e procedurës sipas kësaj Rregulloreje janë lëndët e konfiskuara me afat të kufizuar, ushqimi, mjetet, kulturat bujqësore dhe të kopshtarisë së hershme, kafshët e gjalla, veshëmbathjet dhe pijet joalkoolike, si dhe prona përkohësisht të konfiskuar që nuk mund të shiten, në pajtim me nenin 35 të Ligjit të Menaxhimit të Pasurisë së Konfiskuar dhe Përfitimeve Pasurore në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse.

Neni 5

Gjësendet përkohësisht të konfiskuara në procedurë penale dhe kundërvajtëse, të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, Agjencia mund t'ua japë në përdorim pa kompensim organeve shtetërore, shoqatave (organizatave humanitare) dhe fondacioneve.

Drejtori i Agjencisë miraton vendim për dhënien në përdorim të pronës përkohësisht të konfiskuar organit shtetëror, shoqatave (organizatave humanitare) dhe fondacionit, të cilin ia dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në rast se gjësendet përkohësisht të konfiskuara duhet t'i kthehen personit të cilit i janë konfiskuar, me vendim të formës së prerë të gjykatës ose organit tjetër, institucionit të cilit i është kaluar pasuria e konfiskuar përkohësisht, (organi shtetëror, shoqatat dhe fondacionet (organizata humanitare), nëse është e mundur, mund ta kthejë atë, ose përndryshe vlera e pronës së marrë kompensohet nga Buxheti i RMV-së.

Gjatë marrjes së lëndëve të konfiskuara përkohësisht nga neni 3 i kësaj Rregulloreje, nga ana e shoqatave dhe fondacioneve, shoqatat dhe fondacionet, duhet t'i vendosin projektet në fushën e mbrojtjes së grupeve dhe kategorive të rrezikuara sociale të qytetarëve për të cilat do të shfrytëzohen këto gjësende.

Përderisa shoqata apo fondacioni nuk jep konfirmim për projekt aktiv në fushën e mbrojtjes së grupeve dhe kategorive të rrezikuara sociale të qytetarëve, i cili do t'i shfrytëzonte pikat nga neni 3 i kësaj rregulloreje, atëherë me vendim mund të vendosë drejtori i Agjencisë me aktvendim të mos i lëshojë gjësendet, ku aktvendimin e dorëzon në Qeverinë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Gjësendet e konfiskuara përkohësisht që janë marrë në procedurë kundërvajtëse doganore dhe janë mallra të huaja dhe për të cilat statusi doganor i gjësendeve nuk është i rregulluar, organet shtetërore, shoqatat (organizatat humanitare) dhe fondacionet duhet të rregullojnë menjëherë statusin doganor të lëndëve që janë dorëzuar në pajtim me Ligjin për Doganat.

Neni 7

Objektet e konfiskuara përkohësisht me vlerë historike, shkencore ose artistike fotografohen nga autorët dhe fotot e tyre i bashkëngjiten dosjes së sendeve të sekuestruara.

Objektet e sekuestruara me vlerë të veçantë shkencore ose artistike Agjencia i dorëzon për ruajtje në institucion përkatës si muze, Arkivi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, NUB Shën Kliment Ohërski ose institucione tjera kompetente për ruajtje varësisht nga lloji i objektit, për të cilin përpilohet procesverbal.

Drejtori i Agjencisë mund të lidhë marrëveshje për ruajtjen e sendeve me institucionin kompetent ku janë dorëzuar sendet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 8

Për trajtimin e sendeve të konfiskuara përkohësisht në procedurë penale, kundërvajtëse dhe administrative, si ushqimet që prishen, pijet joalkoolike, kulturat bujqësore dhe të hershme të kopshtarisë, materialet e farës, produktet për mbrojtjen e bimëve dhe sende të tjera të ngjashme, Agjencia do të kërkojë mendim nga Agjencia e Ushqimit dhe Mjekësisë Veterinare, nëse autoriteti që ka konfiskuar këto sende nuk e ka marrë më parë. Në rast të mendimit negativ, sendet asgjësohen menjëherë në pajtim me nenin 72 të Ligjit për administrimin e pasurisë së konfiskuar, përfitimit pasuror dhe sendeve të sekuestruara në procedurë penale dhe kundërvajtëse.

Pasuria e përbërë nga kafshë të gjalla u dorëzohet personave juridikë të veçantë, të cilët kanë regjistrimin dhe licencën përkatëse për t'u marrë me kafshët e gjalla, me të cilat Agjencia ka lidhur një marrëveshje kuadër përmes prokurimit publik që kryhet në nivel vjetor, ose institucioneve shtetërore që kanë bazat e tyre të mbarështimit dhe plotësojnë kushtet për mbajtjen e tyre. Trajtimi i kafshëve të gjalla rregullohet nga një rregullore e veçantë.

Pjesa tjetër e pasurisë së konfiskuar që nuk mund të shitet ose të jepet pa kompensim për arsye shëndetësore, veterinare, sigurie, fitosanitare dhe të tjera, si barnat, duhani i falsifikuar, alkooli dhe produkte të tjera për të cilat nuk ka deklarim, duhet të asgjësohet në deponi në përputhje me rregulloret ligjore pozitive.

Në rastet kur bëhet fjalë për mallra të natyrës që prishen, kafshë të gjalla që merren për arsye që Agjencia nuk ka kushte për mbajtjen e tyre, në bazë të një mendimi të marrë më parë nga Agjencia e Ushqimit dhe Mjekësisë Veterinare ose në një mendim të marrë nga organi që i ka marrë, kryetari i Bordit Drejtues të Agjencia mund të caktojë seancën e Bordit Drejtues sa më shpejt që të jetë e mundur në përputhje me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Bordit Drejtues të Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar b4.0202-712/16 të datës 02.07.2025.

Në bazë të mendimit pozitiv të marrë nga organet kompetente, bordi drejtues është i obliguar që për shkak të urgjencës së procedurës, menjëherë të marrë vendim për asgjësimin e mallit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, pas së cilës drejtori merr vendim për asgjësimin e mallit të njëjtë.

Neni 9

Shpenzimet e marrjes së mallit të konfiskuar përkohësisht organeve shtetërore, shoqatave (organizatave humanitare) dhe fondacioneve i bartin vetë institucionet të cilave u është caktuar pasuria e konfiskuar përkohësisht.

Neni 10

Drejtori i Agjencisë, para se t'ua japë në përdorim gjësendet përkohësisht të konfiskuara, organeve shtetërore dhe/ose shoqatave dhe fondacioneve nga neni 3 i kësaj rregulloreje, bën rivlerësimin e vlerës së pronës përkohësisht të konfiskuar dhe lëndëve të konfiskuara përkohësisht nëpërmjet vlerësuesit të autorizuar ose nëpërmjet Byrosë së Vlerësimit.

Para marrjes së lëndëve përkohësisht të konfiskuara nga neni 3 i kësaj Rregulloreje, drejtori i Agjencisë, i drejtohet me kërkesë për mendim Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë, nëse gjësendet i plotësojnë kushtet shëndetësore, veterinare, fitosanitare dhe të sigurisë. Nëse mendimi është negativ, gjësendet asgjësohen sipas ligjit.

Veprimi në këto raste është urgjent.

Neni 11

Drejtori i Agjencisë lidh memorandum për bashkëpunim me shoqatat dhe fondacionet që ndërmarrin aktivitete në fushën e mbrojtjes së grupeve dhe kategorive të rrezikuara sociale të qytetarëve, në kuadër të veprimtarisë së tyre të regjistruar.

Për lidhjen e memorandumit të bashkëpunimit me shoqatat dhe fondacionet, drejtori publikon thirrje në uebfaqen e Agjencisë, e cila është e hapur gjatë gjithë vitit.

Shoqatat dhe fondacionet paraqiten në mënyrë të pavarur në thirrje, ndërsa gjatë paraqitjes janë të obliguar të tregojnë projektin apo projektet aktuale në fushën e mbrojtjes së grupeve dhe kategorive të qytetarëve në nevojë sociale. Shoqatat dhe fondacionet janë të detyruar të paraqesin gjatë dorëzimit të paraqitjes, certifikatë nga Regjistri Qendror për të përcaktuar veprimtarinë e tyre, si dhe listë të projekteve të mëparshme aktuale dhe të përfunduara.

3. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 12

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas hyrjes në fuqi, kjo rregullore do të publikohet në uebfaqen e Agjencisë.

Nr. 01-718/1
7.2.2025
Shkup

Agjencia për Menaxhimin e
Pasurisë së Konfiskuar
Këshilli Drejtues
Kryetari,
Станко Китаноски, d.v.